



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.88

2005

23 nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.708, datë 16.11.2005	Për disa shtesa në vendimin nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave “Për çmimet e shitjes së barnave”, të ndryshuar.....	2839
Vendim i KM nr.711, datë 18.11.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për Statusin “Dëshmor i Atdheut”, të ndryshuar”.....	2839
Vendim i KM nr.712, datë 18.11.2005	Për miratimin e marrëveshjes specifike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë (në fushën e tatimeve).....	2840
Vendim i KM nr.713, datë 18.11.2005	Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të rakorduara ndërmjet shoqërive, për tremujorin e katërt të vitit 2005.....	2843
Vendim i KM nr.714, datë 18.11.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Trajnimit e Nëpunësimit Civil”, të ndryshuar.....	2845
Vendim i KM nr.715, datë 18.11.2005	Për një shtesë në vendimin nr.503, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.....	2845

Vendim i KM nr.717,datë 22.11.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.836 datë 3.12.2004 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë”.....	2846
Vendim i KM nr.718,datë 18.11.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kv, në Sukth-Sallmone, Durrës.....	2846

VENDIM
Nr.708, datë 16.11.2005

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.182, DATË 25.4.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20 e 57, shkronja “c” të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 4.1 të shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) për barnat, që janë gjendje në farmacitë e tregtimit me pakicë dhe që ende nuk janë pajisur me pullë kontrolli, pulla do të përmbajë vetëm këto të dhëna, në ndryshim me ato të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike:

- Emërtimin e autoritetit që lëshon pullën: Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave;

-Emrin e farmacisë së tregtimit me pakicë, e cila i disponon këto barna;

-Rrethin ku ndodhet farmacia, e cila i disponon këto barna:

- Çmimi i barit, i cili plotësohet nga vetë tregtuesit e tregtimit me pakicë, sipas marzheve të miratuara për këtë qëllim.

Dy nëndarjet e para të shkronjës “c” mund të paraqiten edhe në mënyrë të shifruar.

Në këtë rast, pulla e kontrollit vendoset nga vetë farmacitë e tregtimit me pakicë të barnave.”.

2. Në fund të pikës 4.3 të shtohet fjalia, si më poshtë vijon:

“Për barnat, gjendje në farmacitë e tregtimit me pakicë, në pullën e kontrollit të të cilave do të shënohen të dhënat e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 4. 1, afati i pajisjes me pullën e kontrollit të jetë data 31 dhjetor 2005.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2005.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.711, datë 18.11.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a” e pikës 1 të vendimit nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë vijon:

a) Përbërja e komisionit qendror për statusin “Dëshmor i Atdheut”, pranë Këshillit të Ministrave, të jetë:

- zëvendëskryeministri

kryetar;

- zëvendësministri i Mbrojtjes

nënkryetar;

- zëvendësministri i Drejtësisë

anëtar

- zëvendësministri i Brendshëm

anëtar;

- zëvendësministri i Punës,

Çështjeve Sociale dhe Shanseve

të Barabarta

anëtar;

- një përfaqësues i Organizatës

Kombëtare të Familjeve të

Dëshmorëve të LANÇ-it dhe
dëshmorëve të tjerë të Atdheut anëtar;
- një përfaqësues i Organizatës
së Bashkuar të Veteranëve
të Luftës që mbulon familjet e
dëshmorëve të Atdheut anëtar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.712, datë 18.11.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SPECIFIKE, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË
(NË FUSHËN E TATIMEVE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes specifike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Suedisë (në fushën e tatimeve).
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SPECIFIKE
NDËRMJET QEVERISË SË SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SHQIPËRISË

Qeveria e Suedisë dhe Këshilli i Ministrave i Shqipërisë (këtej e tutje referuar si “Suedia” dhe “Shqipëria”), kanë rënë dakord si më poshtë:

Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Shqipërisë (DPT), do t’u jepet autoriteti të përfaqësojnë qeveritë e tyre respektive për çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1
Lidhja me marrëveshjet e tjera

Bashkëpunimi midis palëve sipas kësaj Marrëveshjeje drejtohet edhe nga:
- Marrëveshja mbi termat dhe kushtet e përgjithshme për zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë për periudhën 2001-2005, nënshkruar më 5 prill 2001.
- Çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë apo ndryshojë marrëveshjet në fjalë.

Neni 2
Fusha dhe objektivat e Marrëveshjes

Shqipëria ka vendosur të zbatojë një projekt të quajtur bashkëpunimi shqiptaro-suedez në administratën tatimore.

Objektivat kryesore të projektit është përqasja e DPT-së me kërkesat e një administrate tatimore moderne dhe efëiente, sipas standardeve ndërkombëtare dhe europiane.

Objektiva të veçantë janë: Rritja e numrit të tatimpaguesve të kënaqur; hartimi, miratimi dhe

zbatimi i planeve për të punuar në mënyrë homogjene në degën e tatimeve Durrës dhe në degën e tatimpaguesve të mëdhenj; rritja e grumbullimit të të ardhurave; miratimi i projektplanit për ngritjen e qendrës së trajnimit.

Projekti do të zbatohet në përputhje me projektdokumentin original të titulluar “Bashkëpunimin shqiptaro-suedeze në administratën tatimore”, shkurt 2004, i ndryshuar herë pas here.

Neni 3

Kontributi i palës suedeze

Suedia, pas miratimit të fondeve në Parlamentin saj, do të mbështesë zbatimin dhe monitorimin e programit, siç është specifikuar në këtë Marrëveshje, me një shumë prej gjashtë milionë e katërqind mijë kroner (SEK 6 400 000).

Neni 4

Detyrimet e Shqipërisë

Shqipëria merr përsipër:

1. Të zbatojë projektin dhe të sigurojë përdorim efektiv të ndihmës së disponueshme në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. T’i japë përgjegjesi të plotë DPT-së për zbatimin e nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Të përgjigjet që kontributi i palës suedeze të përdoret në mënyrë eficiente vetëm për qëllimet për të cilat është rënë dakord.

4. Të sigurojë të gjitha burimet që janë të nevojshme për zbatimin eficient të projektit. Këtu përfshihet stafi i kualifikuar dhe fondet e mjaftueshme për kostot periodike, si edhe investimet kapitale.

5. Të përgjigjet për koordinimin mes ministrive, donatorëve dhe autoriteteve të tjera apo institucioneve që përfshihen në zbatimin e këtij projekti.

6. Të bëjë rregullimet e duhura për sigurimin gjatë udhëtimit duke përfshirë sigurimin në rast vdekjeje apo invaliditeti për personelin nga Shqipëria që merr pjesë në vizita studimore, në kurse dhe aktivitete të ngjashme profesionale jashtë Shqipërisë, që organizohen nga Suedia apo çdo institucion që ka kontraktuar me Suedinë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Kushtet për dhe mënyra e përdorimit të kontributit suedez

1. Vetëm shpenzimet që kryhen gjatë periudhës janar 2004 deri në dhjetor 2007 financohen nga kontributi suedez. Pas një periudhe gjashtëmujore pas kësaj date, asnjë fond i Marrëveshjes nuk do të jetë i disponueshëm për pagesa.

2. Është kusht paraprak për disbursimin e fondeve suedeze që gjithë burimet për realizimin e projektit, të cilat nuk janë parashikuar nga ana e Suedisë, të alokohen prej Shqipërisë. Një alokim i tillë, siç parashikohet në projektdokument, duhet kryer me një vendim formal të autoritetit kompetent të Shqipërisë. Nëse në projektdokument nuk specifikohet se kur do të bëhet alokimi, atëherë alokimi duhet bërë në mënyrë të mjaftueshme përpara se të sigurohen burimet suedeze për të mundësuar zbatimin dhe vazhdimin sipas planeve për të cilët është rënë dakord.

3. Suedia ka të drejtë që, në çdo kohë, të tërheqë burimet e planifikuara nëse ka shmangie të planeve dhe buxhetit, në rast keqpërdorimi të fondeve apo burimeve të tjera, nëse objektivat e projektit rrezikohen, nëse raportet nuk shpërndahen ashtu si është rënë dakord; nëse menaxhimi financiar i projektit nuk është i kënaqshëm, apo nëse zhvillohet jo në mënyrë të favorshme sipas objektivave për ndonjë aspekt tjetër të rëndësishëm.

4. SIDA mund të ndryshojë apo ndërpresë ndihmën, nëse ka shmangie substanciale nga projektdokumenti original i titulluar bashkëpunimi shqiptaro-suedeze në administratën tatimore, shkurt 2004, apo ndonjë kusht tjetër nuk është realizuar apo nuk është respektuar plotësisht.

Neni 6

Prokurimet

Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve do të kryhet në përputhje me parimet e pranura ndërkombëtare dhe praktikat e mira të prokurimit.

Nuk pranohet asnjë ofertë, dhuratë apo pagesë, konsideratë apo përfitim i çdo lloji që do të përbënte/apo mund të përbënte praktikë joligjore apo korruptive, në mënyrë direkte ose indirekte, si nxitje apo shpërblim për dhënie apo zbatim të kontratave që financohen nga ky projekt.

Suedia do të sigurojë për DPT-në e Shqipërisë, sipas kësaj Marrëveshjeje, shërbime konsulence që prokurohen në përputhje me legjislacionin kombëtar suedez.

Mallrat që prokurohen nga Suedia sipas këtij projekti, bëhen pronë e DPT-së menjëherë me hyrjen e tyre në Shqipëri, në qoftë se nuk bihet dakord ndryshe në Marrëveshje.

Neni 7

Planifikimi, rishikimi, raportimi dhe vlerësimi

1. Palët mbajnë takime të rregullta rishqyrtimit për të planifikuar dhe ndjekur progresin e projektit, të paktën një herë në gjashtë muaj. Një nga këto takime do të përbëjë takimin të shqyrtimit të analizës vjetore.

2. Një draftraport i progresit vjetor duhet të paraqitet në Suedi jo më vonë se 30 ditë para analizës vjetore.

Raporti për progresin vjetor do të përmbajë:

- A. aktivitetet e planifikuara
- B. planin e punës së planifikuar
- C. aktivitetet që janë zbatuar
- D. planin aktual të punës
- E. një analizë dhe vlerësim të veprimtarive të kryera
- F. shpjegim të shmangieve nga plani
- G. analizë të impaktit të projektit

3. Një planvjetor pune duhet të paraqitet në Suedi si draft për analizë dhe diskutime të mëvonshme në takimin e analizës vjetore, jo më vonë se data e caktuar.

Plani i punës do të përmbajë aktivitetet e planifikuara, afatet kohore dhe buxhetin. Në plan diskutohen objektivat, metoda e zbatimit, organizimit dhe faktorët kritikë. Plani i punës do të përfshijë informacion për donatorë të tjerë kryesorë të DPT-së dhe projekte për zbatim nga DPT.

4. Pavarësisht mënyrës rutinë të raportimit të rënë dakord, palët janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur, nëse krijohet një situatë ku projekti nuk zbatohet siç është rënë dakord.

5. Gjatë periudhës së projektit, mund të bëhet një analizë e detajuar apo një vlerësim për të.

6. Shqipëria i siguron Suedisë çdo informacion tjetër të arsyeshëm të kërkuar prej saj në lidhje me projektin dhe u mundëson përfaqësuesve suedezë që të vizitojnë vendndodhjet e projektit dhe të inspektojnë kapitalin, mallrat, të dhëna dhe dokumente. Shqipëria do të bashkëpunojë me Suedinë dhe do ta ndihmojë atë në ecurinë dhe vlerësimin e impaktit të projektit. Detyrimet e Shqipërisë në këtë aspekt janë të aplikueshme edhe për ndihmën e dhënë nga Suedia për projektin, për të cilën është rënë dakord më parë.

Neni 8

Disbursimi

Furnizuesve, konsulentëve dhe personelit të kontraktuar nga Suedia pagesat u bëhen direkt nga pala suedeze.

Neni 9

Kontrolli financiar

Shqipëria do të bashkëpunojë me Suedinë dhe do të asistojë në kryerjen e auditimeve, ndjekjen e detyrave dhe studimeve financiare, që mund të kërkojë Suedia.

Neni 10

Bërja publike e kësaj Marrëveshjeje

Palët marrin përsipër t'u shpërndajnë kopje të kësaj Marrëveshjeje të gjitha ministrive të tyre, autoriteteve dhe institucioneve të tjera që përfshihen në projektin për bashkëpunim, apo të cilët kanë nevojë për informacion në lidhje me përmbajtjen e saj.

Neni 11
Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri më 30 qershor 2008, nëse nuk përfundon më herët me anë të një njoftimi me shkrim (6 muaj para përfundimit) nga secila palë. Në rast përfundimi nga ana e Suedisë, përfundimi nuk do të zbatohet për fonde të dhëna në mënyrë të parevokueshme në mirëbesim nga ana e Shqipërisë palëve të treta, përpara datës së njoftimit për përfundimin e Marrëveshjes, nëse dhënia e tyre është bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

Në rast shkeljeje serioze të Marrëveshjes, Suedia mund ta ndërpresë atë me efekt të menjëhershëm.

Në rast të përfundimit nga ana e Shqipërisë, asnjë fond nuk bëhet i disponueshëm për aktivitete pas përfundimit të afatit të Marrëveshjes.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi menjëherë sapo të dy palët të bëjnë njoftimin për plotësimin e procedurave të brendshme për miratimin e saj.

Dy kopje (autentike të tekstit) të kësaj Marrëveshjeje në gjuhën angleze janë firmosur, dhe secila palë ka marrë kopjen e vet.

Vendi dhe data
Për Qeverinë e Suedisë

Vendi dhe data
Për Këshillin e Ministrave

Fredrik Schiller
Ministër

Nëse Suedia merr përsipër të rekrutojë ekspertë për projektin, atëherë zbatohen dispozitat në vijim. Ato mund të përfshihen si nen i veçantë me titullin asistencë teknike. Shih tekstin opsional më poshtë.

VENDIM
Nr.713, datë 18.11.2005

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA, TË RAKORDUARA NDËRMJET
SHOQËRIVE, PËR TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 2 1.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 127 433 (njëqind e njëzetë e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre mijë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH, sh.a.-së, për energjinë elektrike, përkatësisht, të minierës së qymyrgurit, Kërrabë, në vlerën 13 160 (trembëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të minierës së qymyrgurit, Mushqeta, në vlerën 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë, të Albakër, sh.a.-së, në vlerën 87 273 (tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë) lekë.

Ky fond të përdoret për likuidimin e detyrimeve të prapambetura që KESH, sh.a.-ja, ka ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 372 567 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekësh për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj KESH, sh.a.-së, për energjinë elektrike, të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Fondi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i planifikuar për vitin 2005.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E DETYRIMEVE TE PRAPAMBETURA TE SH.A.
UJESJELLES KANALIZIMEVE NDAJ SH.A. KESH-IT PER
ENERGJINE ELEKTRIKE TE KONSUMUAR DERI 30.06.2005

000/lekë

Nr	Emertimi i sh.a.	Detyrimi 30.06.2005
1	Sh.a. ujesjelles kanalizime Durres	137079
2	Sh.a. ujesjellesi Kavaje	5148
3	Sh.a. ujesjellesi Patos	32887
4	Sh.a. ujesjellesi Vlore Qytet	35385
5	Sh.a. ujesjellesi Pogradec	15976
6	Sh.a. ujesjellesi Elbasan Fshat	28047
7	Sh.a. ujesjellesi Kucove	8928
8	Sh.a. ujesjellesi Tropoje	4421
9	Sh.a. ujesjellesi Lezhe	10915
10	Sh.a. ujesjellesi Shkoder Qytet	28303
11	Sh.a. ujesjellesi Kurbin	14185
12	Sh.a. ujesjellesi Tepelene	5728
13	Sh.a. ujesjellesi Sarande	3265
14	Sh.a. ujesjellesi Lushnje Qytet	4856
15	Sh.a. ujesjellesi Lushnje Fshat	2099
16	Sh.a. ujesjellesi Fier	35345
	Totali i detyrimit	372567

VENDIM
Nr.714, datë 18.11.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.315, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË TRAJNIMIT TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE TRAJNIMIN E NËPUNËSIT CIVIL”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.315, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto

ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1 të kapitullit I “Krijimi dhe funksionimi i Institutit të Trajnimit të Administratës Publike”, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Krijimin e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (më poshtë Instituti), institucion në varësi të Ministrit të Brendshëm.”.

b) Shkronja “a” e pikës 11, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) financimi nga Buxheti i Shtetit”.

2. Numri i punonjësve të parashikuar për Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, si dhe fondi i pagave, i shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore të kalojnë nga Kryeministria te Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.715, datë 18.11.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.503 DATË 30.6.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.503, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1

a) Paga e kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara njësohet me pagat e kategorisë III A, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore, të ndryshuar me vendimet përkatëse”, të ndryshuar.

b) Paga e administratorëve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara njësohet me pagat e kategorisë III B, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Financave.

3. Ngarkohet Ministri e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.717, datë 22.11.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.836 DATË 3.12.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.836, datë 3.12.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
 “1. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, si organ vendimmarrës, kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:
- | | |
|--|------------------|
| - Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | zëvendëskryetar; |
| - Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| - Ministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministri i Brendshëm | anëtar; |
| - Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit | anëtar; |
| - Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | anëtar; |
| - Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes | anëtar; |
| - Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, | sekretar.”. |
2. Në pikën 5, emërtimi “Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit”, zëvendësohet me “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”.
 Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.718, datë 18.11.2005

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV, NË SUKTH-SALLMONE, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, në Sukth-Sallmone, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së.
 - Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, për sipërfaqen prej 4252 (katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) me tokë bujqësore, arë, në shumën e përgjithshme prej 7 653 600 (shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekësh, sipas masës së përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - Ky fond të përballët nga KESH, sh.a.-ja, zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.
 - Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 170 000 (njëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga KESH, sh.a.-ja, si kërkuesi për shpronësim.
 - Procedura e shpronësimit të fillojë brenda muajit nëntor 2005 dhe të përfundojë brenda vitit 2005.
 - Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH, sh.a.-ja, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110/20 KV SUKTH-SALLMONE, DURRËS"

RRETHI : DURRËS
KOMUNA: XHAZOTAJ, FSHATI SALLMONE

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet : **Tokë Bujqësore Arë**

Nr.	Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Faqe	Sip. në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	IBRAHIM	MUÇA	Tokë Bujqësore	3255	87/71	105	400	1800	720.000
2.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/82	120	106	1800	190.800
3.	FADIL	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/97	140	421	1800	757.800
4.	FADIL	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/74	115	220	1800	396.000
5.	FIQIRI	DOMI	Tokë Bujqësore	3255	87/91	124	530	1800	954.000
6.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/94	127	695	1800	1.251.000
7.	IBRAHIM	PEZA	Tokë Bujqësore	3255	87/83	121	625	1800	1.125.000
8.	BEKTASH	DRIZA	Tokë Bujqësore	3255	87/88	107	625	1800	1.125.000
9.	PETRIT	MEMOÇI	Tokë Bujqësore	3255	87/86	112	425	1800	765.000
10.	FERIK	VEZI	Tokë Bujqësore	3255	87/77	117	205	1800	369.000
Totali							4.252		7.653.600

Sqarime : Shpenzime procedurale: Publikime 170.000 (njëqindeshatëdhjetëmijë) lekë.

Vlera totale e shpronësimit = 7.653.600+ 170.000= 7.823.600 (shtatëmilion e tetëqindenjëzetëetremijë e gjashtëqind) lekë.

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë: njërive postare të qyteteve;
Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042 555 63; 267 468
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. Regjistri i depozitimit të parave ose vlerave të tjera
2. Regjistri i përgjithshëm i akteve dhe i veprimeve materiale
3. Regjistri i testamenteve
4. Indeksi alfabetik

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005)....	1500
4.	PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. KODI DOGANOR
2. KODI DETAR

Doli nga shtypi më 23.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 100 lekë